

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE 2025

Lënda: Filozofi dhe Sociologji

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me **zhvillim dhe arsytim**.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Kërkesa	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Kërkesa	15	16	17	18	19	20	21
Pikët							
Kërkesa	22	23	24	25	26	27	28
Pikët							
Kërkesa	29	30	31	32	33		
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

Sociologji

1. Një violonçelist rumun i vlerësuar ndërkombëtarisht, gjatë një interviste për një televizion vendas, theksoi mundësitë që Franca i kishte dhënë për suksesin e arritur. Ai mbivlerësoi çdo aspekt të kulturës franceze që lidhej me artin, muzikën, etikën e punës, meritokracinë etj. Një vlerësim i tillë kulturor lidhet me: **1 pikë**

- A) nënkulturën.
- B) etnocentrizmin.
- C) ksenocentrizmin.
- D) kundërkulturën.

2. Një grup nxënësish po përgatiten për një ekspozitë rreth trashëgimisë kulturore të vendit tonë. Ata po diskutojnë të vendosin simbolet kombëtare si: flamurin dhe kostumet popullore sipas zonave, për një përfaqësim sa më të mirë.

Cila nga alternativat e mëposhtme e përshkruan më saktë arsyen pse këto janë simbole kulturore? **1 pikë**

- A) Ndryshojnë nga njëri brez në tjetrin.
- B) Njihen vetëm nga njerëzit që i krijojnë.
- C) Përdoren kryesisht për qëllime personale.
- D) Bartin kuptime të përbashkëta tek anëtarët e një kulture.

3. Një grup shokësh nga një qytet i vogël po diskutojnë për kulturat e ndryshme. Njëri prej tyre shprehet se: *"Kultura jonë nuk duhet të përzihet me elementë të huaj nga vendet e tjera, pasi ne kemi mënyrën tonë të veçantë të jetesës dhe traditat tona."*

Si përcaktohet në sociologji ky lloj vlerësimi? **1 pikë**

- A) Globalizëm
- B) Etnocentrizëm
- C) Multikulturalizëm
- D) Relativizmi kulturor

4. *"Omotenashi"* përfaqëson një koncept të rëndësishëm për kulturën japoneze që lidhet me mikpritjen dhe shërbimin. Bazuar në këtë qasje, mospranimi i bakshshit lidhet me normat dhe vlerat sociale të japonezëve. Ndonëse në shumë shtete të tjera bakshishi është një shenjë mirësjellje dhe vlerësimi, japonezët janë mësuar me modelet e kulturës që lartësojnë krenarinë dhe përkushtimin për punën.

Shembulli për sjelljen e japonezëve lidhet me: **1 pikë**

- A) socializimin.
- B) stratifikimin social.
- C) ksenocentrizmin.
- D) asimilimin.

5. Bazuar në ligjin *"Për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare"*, janë vendosur tabelat rrugore në gjuhën shqipe dhe greke për të garantuar të drejtat e komunitetit që jeton në këtë zonë. Komuniteti grek që jeton aty, përfaqëson një pakicë: **1 pikë**

- A) fetare.
- B) racore.
- C) mongoloide.
- D) kombëtare.



6. Gjatë shekujve XVIII-XIX për shkak të zhvillimit të industrisë ndryshoi mënyra e jetesës dhe struktura klasore e shoqërisë, duke krijuar zonat urbane. Cila nga alternativat e mëposhtme përfaqëson një veçori kryesore të urbanizimit gjatë periudhës së industrializimit? **1 pikë**
- A) Vetëm zhvillimi dhe modernizimi i bujqësisë.
 B) Krijimi i sistemeve feudale të zotërimit të tokës.
 C) Rritja e popullsisë dhe përqendrimi në qendrat urbane.
 D) Krijimi i sistemeve të ngurta të kastës që kufizojnë lëvizshmërinë shoqërore.
7. Rituale të organizimit të dasmës së Brikenës ishin sipas zakoneve të krahinës dhe zgjatën disa ditë. Çdo pasdite, të afërm e miq hidhnin valle në oborrin e shtëpisë. Ditën e diel, përpara se Brikena të hynte në derë, vjehrra ia bëri gishtat me mjaltë dhe leu traun e shtëpisë.
 Ky përshkrim është karakteristikë për shoqëritë: **1 pikë**
- A) moderne.
 B) tradicionale.
 C) pasmoderne.
 D) pasmaterialiste.
8. Revolucioni i informacionit ka ndikuar në rimodelimin e shoqërisë duke krijuar profilin e shoqërisë: **1 pikë**
- A) moderne.
 B) tradicionale.
 C) pasmoderne.
 D) bashkësi.
9. Iliri vjen nga një familje e varfër, në të cilën prindërit punonin për të siguruar mbijetesën dhe nevojat për arsimimin e fëmijëve. Pas përfundimit të studimeve universitare me shumë sakrifica dhe vullnet, ai filloi punë në një kompani ndërkombëtare dhe pas disa vitesh u bë drejtues i saj.
 Kjo dukuri shoqërore në sociologji lidhet me: **1 pikë**
- A) luftën e klasave.
 B) lëvizshmërinë shoqërore.
 C) trashëgiminë ekonomike të familjes.
 D) ndryshimin horizontal të statusit individual.
10. Në eksperimentin sociologjik të realizuar rreth viteve '30 në një fabrikë pranë Çikagos, shkak kryesor i efektit "hauthorne" për ndryshimin e modeleve të sjelljes së njerëzve, ishte: **1 pikë**
- A) mjedisi fizik në të cilin kryhej studimi.
 B) faktori racor i pjesëmarrësve në studim.
 C) sfondi kulturor i pjesëmarrësve në studim.
 D) prania e studiuesve ose vëzhguesve në studim.

11. Bazuar në pikturën me motive nga një dasmë, identifikoni dhe përshkruani dy përbërës të sistemit kulturor shqiptar.

2 pikë



- 1) _____
- _____
- 2) _____
- _____

12. Tradicionalisht aborti është konsideruar si sjellje e ndaluar shoqërisht dhe ligjërisht. Megjithatë situata në shumë shtete ka ndryshuar, duke u konsideruar si një e drejtë. Në 2018 Irlanda legalizoi abortin dhe përcaktoi kushtet në të cilat ai do të ishte i ligjshëm. Analizoni dukurinë e ndërprerjes së shtatzënisë bazuar në: **4 pikë**

- a) karakterin relativ të deviancës nga një kulturë në tjetrën:

- b) ndryshime në rrjedhën e kohës:

13. Joni është transferuar së fundi nga një fshat i vogël në Tiranë. Ai vëren se mundësitë për punë dhe argëtim janë të shumta, por mezi i përballon shpenzimet dhe ritmin e shpejtë të jetës. Mungesa e kontakteve me fqinjët, trafiku i rënduar dhe ndotja, i shkaktajnë stres të vazhdueshëm. Duke iu referuar tekstit të dhënë, analizoni tre ndryshime mes mënyrës urbane dhe asaj rurale të jetesës. **3 pikë**

- 1) _____
- _____
- 2) _____
- _____
- 3) _____
- _____

14. Studimi i bazuar në anketën sociologjike për disa shtete evropiane, tregon se një numër gjithnjë e më i pakët i të rinjve ndjekin praktika dhe ceremoni fetare, duke u shprehur se: *“Ne nuk i kemi braktisur vlerat e besimit, thjesht po i shprehim ndryshe, jashtë strukturave tradicionale.”*
Shpjegoni dy veçori të shfaqjes së shekullarizimit në këto vende. **2 pikë**

- 1) _____

- 2) _____

15. *“Në shoqëritë në të cilat vepron sistemi i klasave, ligji parashikon të drejta të barabarta për të gjithë. Gratë dhe burrat përparojnë pa dallim në hierarkinë profesionale.”*
Bazuar në pohimin e mësipërm, identifikoni një kriter që ndikon në këtë lëvizshmëri shoqërore në sistemin e klasave. **1 pikë**

Argumentoni qëndrimin tuaj pro ose kundër këtij pohimi. **2 pikë**

16. Andi përballet çdo ditë me presionin e shokëve në lagjen ku banon, të cilët përfshihen në sjellje deviante. Ai ka rezultate të larta akademike dhe shoqërohet me studentë që kanë të njëjtat interesa si ai për të ardhmen. Ndërsa në kohën e lirë ndihmon prindërit në biznesin familjar, pa lënë pas dore stërvitjen në not.
Bazuar në këtë situatë, përshkruani tre faktorë që, sipas sociologut Trevis Hirshi, kontrollojnë sjelljen deviante. **3 pikë**

- 1) _____

- 2) _____

- 3) _____

17. Lëvizja feministe, bëri thirrje për drejtësi, duke marrë shkas nga dhuna e ushtruar ndaj grave. Gjithashtu theksoi se kriza ekonomike po dëmton sidomos gratë në nivelin e pagave. Vëmendja u drejtua edhe ndaj legalizimit të abortit.
Bazuar në shembullin e dhënë, përcaktoni tre synimet e lëvizjes feministe: **3 pikë**

- 1) _____

- 2) _____

- 3) _____

Filozofi

18. Filozofët sofistë të lashtësisë greke ishin mësues dhe mendimtarë që ofronin mësim për çështje si etika, logjika dhe politika. Ata nxitën debatin e hapur mbi natyrën e ligjit, moralit dhe dijes, sepse besonin se: **1 pikë**

- A) të vërtetat ishin universale dhe të pandryshueshme.
- B) njohuritë mund të arriheshin vetëm përmes logjikës dhe shkencës.
- C) traditat e lashta dhe normat shoqërore janë burimi i të vërtetave.
- D) të vërtetat ishin subjektive dhe vareshin nga perceptimi individual dhe shoqëror.

19. Seneka, një nga filozofët më të njohur të stoicizmit në Romën e lashtë, besonte se lumturia e njeriut arrihej përmes: **1 pikë**

- A) pasurisë materiale dhe pushtetit.
- B) jetës së virtutshme dhe qetësisë së shpirtit.
- C) kënaqësive të përkohshme për të shmangur vuajtjet.
- D) njohurive shkencore ekzakte për natyrën dhe universin.

20. Filozofi dhe teologu i Mesjetës në Evropë, Thoma Akuini, në njërën prej provave të tij që vërtetojnë ekzistencën e Zotit, pohon se: **1 pikë**

- A) sendet dhe dukuritë krijohen vetiu.
- B) asgjë në botë nuk ndodh pa një shkak.
- C) njeriu është qenie e domosdoshme nga vetvetja.
- D) fenomenet bazohen në ligjësi të brendshme natyrore.

21. Filozofia politike e Kampanelës, e cila synonte të ndërtonte një shoqëri sipas modelit në veprën “*Qyteti i Diellit*”, u konsiderua si filozofi: **1 pikë**

- A) realiste.
- B) utopiste.
- C) anarkiste.
- D) reformiste.

22. “*Le të supozojmë që mendja është fletë e bardhë, pa asnjë shenjë, pa asnjë ide. Si mund të mbushet? Nga vjen gjithë ajo pasuri e pashtershme që njeriu e ka pikturuar me një larmishmëri pothuajse të pashtershme? Nga i merr materialet për arsyetim dhe njohuri? Kësaj unë i përgjigjem me një fjalë: nga eksperiencia. Në të mbështetet e gjithë njohuria jonë...*”

Ky përshkrim lidhur me burimin e njohjes, bazohet në konceptin e filozofit:

1 pikë

- A) Platon
- B) Dekart
- C) Loku
- D) Spinoza

23. Lëvizja intelektuale e shekullit XVIII është:

1 pikë

- A) iluminizmi.
- B) ekzistencializmi.
- C) obskurantizmi.
- D) materializmi.

24. Hobsi, një nga filozofët më të rëndësishëm politikë të epokës moderne, është i njohur për teorinë mbi shtetin dhe origjinën e tij. Në veprën *"Leviatani"*, ai argumenton se shteti lindi si: **1 pikë**

- A) marrëveshje mes sovranëve.
- B) kontratë shoqërore mes individëve.
- C) shprehje e vullnetit të Zotit në tokë.
- D) bashkëpunim i qeveritarëve me popullin.

25. Pohimi: *"Nuk ka asnjë thelb që paraprin ekzistencën."*, lidhet me drejtimin filozofik të: **1 pikë**

- A) empirizmit.
- B) pragmatizmit.
- C) strukturalizmit.
- D) ekzistencializmit.

26. Marksi e shihte historinë si një përplasje të vazhdueshme mes grupeve të ndryshme shoqërore, që çojnë në ndryshime social-ekonomike dhe politike. Filozofia e tij është quajtur shpesh *"revolucionare"*, sepse ai beson në: **1 pikë**

- A) ruajtjen e rendit ekzistues dhe stabilitetit të klasave shoqërore.
- B) rëndësinë e ndryshimeve graduale dhe reformave paqësore në shoqëri.
- C) luftën e klasave si forcë shtytëse e historisë për përmbysjen e kapitalizmit.
- D) sistemin kapitalist si rend ekonomik i drejtë dhe i barabartë për të gjithë individët.

27. Shprehja e Dekartit *"Cogito, ergo sum"* (*"Mendoj, prandaj jam"*), shpreh bindjen e tij se në themel të ekzistencës qëndron aftësia për të menduar, dyshuar dhe arsyetuar. Filozofia e Dekartit i përket rrymës: **1 pikë**

- A) realiste.
- B) utopiste.
- C) racionaliste.
- D) materialiste.

28. Protagora ishte një nga përfaqësuesit më me ndikim të drejtimit sofist. Ai shprehej: *"Njeriu është masa e të gjitha gjërave"*. Përcaktoni katër karakteristika të parimeve morale sipas sofistëve. **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

29. Seneka shprehej: *"Asnjë person nuk ka fuqinë të ketë gjithçka që dëshiron, por ai ka fuqinë të mos dëshirojë atë që nuk ka dhe të përdorë me gëzim atë që ka."*

Shpjegoni tre parime morale të etikës stoike për jetën. **3 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____

30. Rilindja është një periudhë e rëndësishme historike dhe kulturore, që lindi në Evropë gjatë shekullit XIV-XVII, duke shënuar një *"ringjallje"* të dijes dhe kulturës së lashtë. Rilindasit sollën një ndryshim rrënjësor në kuptimin e botës, duke e vënë theksin tek njeriu dhe fuqia e tij krijuese. Analizoni tre nga tiparet më kryesore të Rilindjes. **3 pikë**

- 1) _____

- 2) _____

- 3) _____

31. Të gjithë ne, gjatë jetës, përballemi me sfida të vështira dhe ndonjëherë ndihemi të pafuqishëm t'i përballojmë, prandaj përpiqemi të gjejmë shkakun e tyre. Si e shpjegon Spinoza raportin mes lirisë dhe domosdoshmërisë? A mund të na ndihmojë kjo filozofi për të kuptuar më mirë vendin tonë në këtë botë? Jepni mendimin tuaj. **4 pikë**

Mendimi i filozofit _____

Qëndrimi juaj _____

32. Filozofi gjerman Haideger, në veprën e tij *"Qenia dhe Koha"*, shqyrton thelbin e përvojës së ekzistencës njerëzore. Për Haidegerin ankthi është përjetimi që na bën të kuptojmë se ekzistenca jonë është e mundur vetëm përmes përballjes me kufizimet dhe mundësitë tona dhe kjo na hap rrugën për një ekzistencë autentike dhe të vetëdijshme.

Analizoni pikëpamjen e filozofit dhe mbani qëndrimin tuaj lidhur me të. **2 pikë**

Ankthi si përjetim ekzistencial _____

Qëndrimi juaj _____

33. Niçe është një nga filozofët më të rëndësishëm të shekullit XIX, i cili kritikoi ashpër vlerat e moralit tradicional, të cilin ai e quajti *"moral i skllëvërve"*, duke krijuar modelin e njeriut të ardhshëm. Shpjegoni idetë e tij lidhur me konceptet e mëposhtme, duke mbajtur qëndrimin tuaj për secilën. **4 pikë**

E mira dhe e keqja _____

Qëndrimi juaj _____

Mbinjeriu _____

Qëndrimi juaj _____
